

Të Mësuarit më Shumë për Lutjen

VEPRIMTARIA A

Cilat janë disa arsye pse Ati Qiellor dëshiron që ne të lutemi ndërkohë që Satani na tundon që të mos lutemi?

- Cilat janë disa mënyra se si Satani mund të na tundojë që të mos lutemi?

Një nga mënyrat se si Satani mund të na “mësojë [ne] që të mos lute[mi]” është duke u përpjekur të na bindë për gënjeshtrenë që, për shkak se kemi mëkatuar, nuk jemi më të denjë për t’u lutur.

Përsiat se çfarë bekimesh mund të jetë duke u përpjekur Satani të na pengojë që t’i marrim ndërsa bën sa vijon:

Shpenzo ca kohë duke studiuar për lutjen. Mund të bësh kërkime për lutjen tek Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta ose të kërkosh biseda të konferencave të përgjithshme që flasin për lutjen. Ndërsa studion, kërkoni bekimet e lutjes. Nëse dëshiron, mund të mendosh për bekimet që ke përjetuar nga lutja në jetën tënde. Duke u bazuar te studimi dhe përvojat e tua, përsiat pse Ati Qiellor dëshiron që ne të lutemi dhe pse Satani na tundon të mos lutemi.

Shkruaj të paktën dy të vërteta që mësove për lutjen. Përfshije arsyen pse mendon se Ati Qiellor dëshiron që ne të lutemi dhe pse Satani na tundon të mos lutemi.

VEPRIMTARIA B

Çfarë do të thotë të lutemi gjithmonë?

Merre parasysh ta shenjosh frazën “lut[uni] gjithmonë dhe mos u jepni” (2 Nefi 32:9).

Lexo tek Alma 34:21, 27, duke kërkuar ide për atë se çfarë mund të nënkuptojë që të lutemi gjithmonë.

- Pse lutja “në mëngjes, në mesditë dhe në mbrëmje” (Alma 34:21) do të ishte një bekim?
- Si mund t’i drejtojmë zemrat tona te Perëndia, edhe kur nuk jemi duke u lutur?

Plaku Dejvid A. Bednar, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dha një shembull rreth asaj se çfarë do të thotë të lutemi gjithmonë:



“Këshilloh[uni] me Atin Qiellor në lutjen e mëngjesit. . . .

Gjatë gjithë ditës mbajmë në zemër një lutje për ndihmë dhe udhëheqje të vazhdueshme. . . .

Në përfundim të ditës sonë ne gjuhëzohemi përsëri dhe i raportojmë Atit tonë. Ne shqyrtojmë sërish ngjarjet e ditës dhe shprehim falënderime të përzemërta për bekimet dhe ndihmën që morëm. Ne pendohejmë dhe, me ndihmën e Shpirtit të Zotit, përcaktojmë mënyra për të vepruar e për t’u bërë më të mirë nesër. Prandaj lutja e mbrëmjes mbështetet dhe është vazhdim i lutjes sonë të mëngjesit. Dhe lutja jonë e mbrëmjes është gjithashtu përgatitje për lutje kuptimplote në mëngjes.” (Dejvid A. Bednar, “Lutuni Kurdoherë”, *Liahona*, nëntor 2008, f. 41–42)

Shkruaje me vetë fjalët e tua se çfarë mendon se do të thotë të lutesh gjithmonë.

VEPRIMTARIA C

Si do t'i shenjtërojë Ati Qiellor përpjekjet tona për mirëqenien, ose përfitimin, e shpirtit tonë?

Nefi udhëzoi që t'i "lut[esh] . . . Atit në emër të Krishtit, që ai të shenjtërojë kryerjen tënde ndaj teje, që kryerja jote mund të jetë për mirëqenien e shpirtit tënd" (2 Nefi 32:9). Të *shenjtërosh* do të thotë të bësh diçka të shenjtë ose të përkushtosh.

Mendo të paktën për një shembull ku Ati Qiellor e bekoji dikë ndërsa ai ose ajo u lut dhe u përpoq fort të bënte atë që Ai dëshironte. Kjo mund të jetë një përvojë vetjake, një shembull bashkëkohor ose mund të gjesësh një ndodhi në shkrimet e shenjta (përdor ndihma si , Indeksi ose Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta për të gjetur një shembull nëse është e nevojshme).

Shkruaje shembullin dhe atë që ai të mësoi rreth mënyrës se si Ati Qiellor do t'i bekojë përpjekjet tona për të përmbushur vullnetin e Tij ndërsa lutemi.